

PARTNERËT:

Veneto Lavoro (Partneri udhëheqës - Itali)
Rajoni Emilia – Romagna (Itali)
Unioni i Dhomave të Tregtisë Veneto – (Itali)
Departamenti i Çështjeve Rajonale
Këshilli Presidencial Italian (Itali)
Obiettivo Lavoro s.p.a. (Itali)
Hydea Consulting Ltd (Hungari)
Dhoma Italiano – Sllovaqe e Tregtisë (Sllovaki)
Obiettivo Lavoro Slovakia s.r.o. (Sllovaki)
Universiteti Katolik i Lublinit "John Paul II" (Poloni)
Universiteti i Thesalisë, Departamenti i Planifikimit
dhe Zhvillimit Rajonal (Greqi)
Ministria e Punës dhe Politikave Sociale (Poloni)
Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" (Shqipëri)
Agjencia e Zhvillimit Rajonal S.C. Plovdiv (Bullgari)
Obiettivo Lavoro Romania s.r.l. (Rumani)



Shpresë për të Ardhmen



Projekt pjesërisht i financuar
nga Bashkimi Europian



Migra value

Orientimi i Kohezionit Ekonomik dhe Social
në Hapësirën CADSES:
Vlerësimi i Migracionit si një Mjet Zhvillimi



Orientimi i Kohezionit Ekonomik dhe Social
në Hapësirën CADSES:
Vlerësimi i Migracionit si një Mjet Zhvillimi

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen"
Bul. "Gjergj Fishta" Kulla 8 Ap.11 Tiranë
Tel./Fax: (04)2224033, (04)2253649
E-mail: shprese@shprese.org
Web: www.shprese.org

2007

Përmbledhje e shkurtër e projektit

MIGRAVALUE, një projekt pjesërisht i financuar nga BE nëpërmjet INTERREG IIB CADSES, ka si qëllim lançimin e një modeli për menaxhimin aktiv të migracionit si një mjet kyç për zhvillimin ekonomik dhe social të rajoneve pritëse dhe të origjinës. Ky projekt përfshin partnerë nga BE si edhe nga vende fqinje të BE, që përfaqësojnë një rrjet të gjerë institucionesh publike dhe private, me kompetencat e duhura dhe interesat të përbashkëta si zhvillimi lokal, burime financiare dhe fonde garancie, migracionin e punës, partneritete të vendeve pritëse – të origjinës, rrjetet mirëqenieje, ku përfshihen bizneset dhe migrantët.

Migravalue synon të forcojë kohezionin hapësinor të rajoneve të përfshira, duke vlerësuar kapitalin financiar dhe njerëzor të migrantëve.



HISTORIKU DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Edhe pse migracioni njihet si faktori kyç për bashkëzhvillimin, vërehet se mungojnë shërbimet mbështetëse. Investimet në vendin e origjinës të migrantëve mbështeten më shumë në iniciativat individuale ose rrjetet informale, ndërsa sistemet kombëtare sociale nuk janë në gjendje të merren me lëvizjet ndërkufitare. Në këtë kuadër, MIGRAVALUE synon të realizojë tre objektiva kryesore:

1. Të zgjerohet vizionet hapësinore të zhvillimit lidhur me lëvizjet migratore dhe strategjitë rajonale të zhvillimit dhe të krijojë një bashkëpunim të ngushtë midis vendeve, pritëse dhe të origjinës. Për të arritur këtë qëllim, do të përmirësojë kohezionin brenda BE dhe me rajonet kufitare të zonës CADSES, në përputhje me qëllimet e politikave të bashkëpunimit dhe integrimit hapësinor.

2. Të mbështesë investimet në vendet e origjinës duke mobilizuar burimet e migrantëve për të financuar iniciativat sipërmarrjesh, duke kufizuar kështu efektet negative të rrjedhjes së trurit dhe duke promovuar qarkullimin e rezultateve pozitive të migracionit, që përfshijnë njohuri të një organizimi të ri dhe metoda konkurruese.

3. Të nxisë veprimet transnacionale për përfshirje sociale në rajonet e synuara: përfitime ekonomike shtesë dhe shërbime me programe të reja mirëqenieje, të cilat mund t'u ofrojnë përgjigjet e duhura nevojave për mbrojtje sociale të aktorëve multinacionalë dhe të ruajnë qëndrueshmërinë sociale në zonat e shenjuara.

PËRFITUESIT

Ky projekt fokusohet në mundësitë e zhvillimit që vijnë nga emigrantët, të cilët vullnetarisht dhe në mënyrë të rregullt largohen nga Shqipëria në kërkim të një jete më të mirë jashtë vendit. Qëllimi i këtij projekti është të inkurajojë një lidhje pozitive midis ekonomive të vendeve të origjinës dhe destinacionit, autoriteteve, institucioneve të zhvillimit dhe aktorëve privatë për të ndërlikur politikat e migrimit me mundësitë hapësinore të integrimit.



AKTIVITETET DHE REZULTATET

Për të arritur objektivat kryesore duke u nisur nga një dinamikë social-ekonomike, projekti MIGRAVALUE kryen veprimet e mëposhtme që pasqyrohen në këto paketa pune:

PP1 (Paketë Pune): analizë e informacionit bazë dhe vlerësimi i tij në 2 komponentë kryesorë:

1. vlerësimi i zhvillimit potencial që vjen nga dërgesat e migrantëve
 2. balancimi i pasojave/efekteve të lëvizjeve jashtë vendit të popullatës
- Rezultatet e këtij studimi të dyfishtë do të shërbejnë si bazë për të përcaktuar sa vijon.

PP2: modele për mbledhjen dhe kanalizimin e dërgesave në skemat e kreditit, lidhjet midis skemave dhe modeleve për plane lokale zhvillimi.

PP3: funksionimi i një fondi garancie për iniciativat biznesi të migrantëve: disa modele të identifikuar do të shërbejnë si plane të integruara operacionale.

PP4: skema për integrimin e të kthyerve, modele për mbështetje aktive sociale në zona me shkallë të lartë emigracioni, shërbime transnacionale të mirëqenies dhe marrëveshje.

Do të zhvillohen sesione trajnimi mbi të dy llojet e modeleve, të ofruara si në formën tradicionale edhe si mësim në distancë.

PP5: një plan komunikimi dhe një sërë aktivitetesh publike do të bëjnë të mundur shpërndarjen dhe rrjedhjen e përgjithshme të rezultateve.

- Një model për menaxhimin e duhur të dërgesave të migrantëve
- Shërbime të përmirësuara për kthime produktive në favor të përfitimeve të përbashkëta të rajoneve pritëse dhe dërguese: plane të integruara operacionale që lidhin kthimet e migrantëve me investimet lokale dhe marrëdhëniet tregtare dypalëshe dhe krijojnë lidhje strukturore midis shërbimeve promovuese për sipërmarrjen private dhe planeve lokale të zhvillimit
- Krijimi i një fondi transnacional garancie për të mbështetur modelet e krijimit të sipërmarrjeve private
- Përmirësimi i kapacitetit të autoriteteve të Anëtarëve të rinj dhe Vendeve fqinje të BE për të hartuar dhe ndërmarrë masa mbrojtëse sociale, të cilat do të lehtësojnë integrimin social të të kthyerve.
- Një model transnacional mirëqenieje, i cili përfshin:
 1. marrëveshje dypalëshe mirëqenieje për personat që banojnë dhe punojnë në të dyja shtetet.
 2. udhëzime për të caktuar fonde dypalëshe ndihme dhe kursimesh të migrantëve për skemat e kujdesit social dhe arsimor.